

Instituti për Studime të Avancuara GAP

MALISHEVA – Raporti komunal

Tetor 2009

Malisheva në shifra

Popullsia	Gjithsej	68,811
	Shqiptarë	99%
	Romë	1%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	306.3
	Numri i fshatrave	43
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	16.81%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	55.81%
	E mesme	23.40%
	Shkollë e lartë	3.64%
	Universitet	0.35%
	Nr. i nxënësve	18,080
	Nr. i mësimdhënësve	869
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	2
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	42
	Nr. i çerdheve	0
	Hapësira shkollore në m ²	
	Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		13
Nr. i mjekëve		20
Papunësia	Gjithsej	37.92%
	Meshkuj	30.81%
	Femra	75.0%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	41,975
	Të punësuar në sektorin publik komunal	1,283
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	6,517,876
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	669,250
	Të hyrat tjera (Euro)	5,848,626
Shpenzimet e realizuara (2008) ¹	Gjithsej (Euro)	5,368,553 (96%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	891,865 (81%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	4,476,688 (99%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	49.46%
	LDK	32.68%
	AKR	4.61%
	LDD	4.52%
	AAK	4.34%
	ORA	1.64%
	Tjera	1.74%
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Jakup Kastrati (LDK) 2002-2007: Gani Krasniqi (PDK) 2007-2009: Isni Kilaj (PDK)	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Malishevën

Emri tjetër i kësaj komune relativisht të re është Llapushë. Komuna e Malishevës ka pasur disa ndërprerje në mëvetësinë e saj territoriale që nga viti kur është njohur për herë të parë si njësi administrative në vitin 1960, për t'u shpërbërë pesë vite më vonë. Më 1986 sërish Malisheva njihet si komunë në vete. Mirëpo për herë të dytë, pas pesë vite të funksionimit të saj të mëvetësishëm, sërish kjo komunë shpërbëhet më 1991. Gjatë luftës së fundit në Kosovë, territori i Malishevës ka qenë arenë e luftimeve të mëdha në mes të UÇK-së dhe ushtrisë serbe. Shumë vendbanime të Malishevës kanë hyrë në histori si arenë të fushëbetejave më të përgjakshme. Malisheva ka pësuar humbje të mëdha në njerëz dhe shkatërrim të infrastrukturës. Pas luftës së vitit 1999, Malisheva sërish merr statusin e komunës dhe zgjedhjet e para lokale në vitin 2000 shërbejnë për formimin e komunës së mëvetësishme dhe ndarjes përfundimtare nga Komuna e Rahovecit. Nëse llogarisim të gjitha vitet e funksionimit të mëvetësishëm të Malishevës, Komuna e Malishevës po hyn në vitin e 10-të të funksionimit të saj pas luftës dhe të 20-të në përgjithësi si komunë në vete.

Problemet aktuale

Që nga pas lufta e vitit 1999, Malisheva ka kaluar nëpër një proces të rindërtimit të infrastrukturës së shkatërruar nga lufta. Problemet më të mëdha të kësaj komune janë problemet me të cilat përballet e tërë Kosova. Në këtë komunë 37.9% e qytetarëve janë të papunë. Problem tjetër me të cilin përballet kjo komunë është edhe rryma elektrike, mirëpo për dallim nga pjesët e tjera të Kosovës, Komuna e Malishevës përballet me reduktime më të mëdha të rrymës. Furnizimin me energji elektrike pritet që ta përmirësojë ndërtimi i trafostacionit në Rahovec. Ky trafostacion i ri do të ndante këto dy komuna nga kontrolli i trafostacionit në Gjakovë. Mirëpo, përveç këtyre problemeve që hasen në tërë Kosovë, Komuna e Malishevës përballet edhe me probleme të natyrës më specifike për këtë komunë, si:

- Kanalizimi i ujërave të zeza;
- Mungesa e ujit të pijes;
- Ethet hemorragjike;
- Gjendja e rëndë në arsim;
- Parregullsitë në administratë.

Kanalizimi i ujërave të zeza. Komuna e Malishevës përbëhet nga 43 lokalitete. Shumë pak prej këtyre lokaliteteve kanë rrjet të kanalizimit. Shumica e vendbanimeve që kanë rrjetin e kanalizimit e kanë arrit këtë me këtë me vetiniciativë dhe me vetëfinancim, lagje për lagje. Përveç qytezës së Malishevës, edhe fshatrat Dragobil, Marali, Maxharr, Bajë, Drenoc, Kërvasari dhe Carallukë kanë rrjet të kanalizimit; kurse në Ostrazub rrjeti i kanalizimit është i shtrirë vetëm në disa pjesë. Mirëpo, edhe përkundër faktit se këto lokalitete kanë të shtrirë rrjetin e kanalizimit, tërë ujërat e zeza derdhen në lumin Mirusha duke e ndotur këtë lum. Malisheva nuk ka impiant për pastrimin e ujërave të zeza. Edhe pse në qendër të qytezës, në pjesën ku kalon lumi Mirusha nëpër qytezë, afër urës janë bërë disa punime në ndërtimin e shtratit të këtij lumi, sërish mund të vërehen gypat e kanalizimit të ujërave të zeza duke rrjedhur përreth murit me gurë përskaaj brigjeve. Këto ujëra të zeza i japin një pamje jo të mirë kësaj pjese të rregulluar të shtratit të lumit. Dërdhja e ujërave të zeza në lum dhe mungesa e një impianti për pastrimin e ujërave të zeza, bën që pjesa ku derdhen kanalizimet të kundërmojnë nga erërat. Ndërtimi i një impianti është shumë i

kushtueshëm për buxhetin komunal që ka kjo komunë. Komuna e Malishevës qëndron mirë sa i përket infrastrukturës rrugore. Këto vite të pasluftës, janë ndërtuar rrugë pothuajse në të gjitha lokalitetet dhe mungesa e rrugëve të asfaltuara nuk përbën shqetësim për këtë komunë. Mirëpo, mungesa e kanalizimeve do të ndikoj që në të ardhmen e afërt ndërtimi i kanalizimeve të prish pjesë të infrastrukturës rrugore.

Mungesa e ujit të pijes. Komuna e Malishevës me ujë të pijes furnizohet nga Bazeni i Bajës. Nga ky bazen furnizohen rreth 15 lokalitete në këtë komunë. Përveç qytetit të Malishevës, rrjet të ujësjellësit kanë edhe Baja, Mirusha, Caralluka, Shkoza, Dragobili, Lubizhda, etj. Por jo në të gjitha lokalitetet ku ka rrjet të ujësjellësit ka edhe ujë. Furnizimin me ujë e rëndon edhe mungesa e energjisë elektrike, pasi që rrjeti i ujësjellësit është i lidhur me energji elektrike. Në mungesë të energjisë elektrike, edhe uji ndalet për shkak se nuk ka gjeneratorë që do të aktivizoheshin. Edhe pse ekziston ujësjellësi në fshatin Carallukë, ky fshat nuk furnizohet rregullisht me ujë të pijes për shkak të terrenit të pjerrët dhe shtypjes së ulët që ka ujësjellësi. Edhe në fshatin Shkozë nuk ka furnizim të rregullt me ujë, për shkak të ndaljes së shpeshtë të energjisë elektrike. Sipas bashkëbiseduesve në këtë hulumtim, kualiteti i ujit të pijes është shumë i dobët dhe ekupe të ndryshme mjekësore që kanë bërë testet në bunarët e këtyre lokaliteteve kanë rekomanduar që ky ujë të mos përdoret për pije. Fshatrat e tjera të kësaj komune nuk kanë rrjet të ujësjellësit. Kurse ato që kanë nuk janë të kënaqura me furnizimin me ujë. Shumë lokalitete e shohin fshatin Bajë, ku është i vendosur burimi i ujësjellësit, si keqpërdorues të ujit të pijes, pasi që sipas tyre ky lokalitet ka gjithnjë ujë të mjaftueshëm edhe për ujitje, çka ndikon që të dobësohet shtypja e ujit për lokalitetet tjera. Fshatrat që nuk janë të këqyr në rrjetin e ujësjellësit e kanë të vështirë të sigurojnë ujin e pijes. Hapja e një pusi për ujë të pijes kushton 3,000 – 4,000 euro, shifër e paarrtshme për shumë familje të kësaj komune.

Ethet Hemorragjike. Një nga problemet më të mëdha shëndetësore me të cilat përballlet kjo komunë gjatë stinës së verës është pickimi nga rriqrat – ethet hemorragjike. Askush nuk mund të thotë me saktësi se përse ky problem është më evident në këtë komunë se sa në komunat tjera të Kosovës. Një nga shkaktarët e etheve hemorragjike është mbajtja e kafshëve, ambienti dhe papastërtia. Banorët e kësaj ane kanë këtë problem më së shumti e ndjejnë në periudhën mars-gusht të çdo viti. Përkundër zërave se ky problem ka filluar të mos ndihet në masë të madhe si vite më parë, këtë verë nga pickimi i rriqrave kanë vdekur dy bashkëshortë, kurse fëmijët e tyre u kanë shpëtuar etheve hemorragjike. Katër raste kanë qenë të raportuara në QKUK dhe gjithsejtë janë raportuar rreth 900 raste (në vitin 2008 kanë qenë rreth 600 raste të evidentuara). Edhe përkundër këtij problemi të madh shëndetësor, Komuna e Malishevës nuk ka infektolog të angazhuar në shëndetësinë primare. Mungesën e infektologut Drejtorati për Shëndetësi i kësaj komune e arsyeton me atë se vetëm shëndetësia sekondare dhe ajo terciare kanë të drejtë që të angazhojnë infektolog. Duke marrë parasysh specifikat e kësaj komune, shumë qytetarë shprehin se Drejtorati i Shëndetësisë dhe Ministria e Shëndetësisë, do të duhej që të angazhohen në drejtim të sigurimit të një infektologu për kohë të shkurtër kohore. Eliminimi i etheve hemorragjike ka qenë temë debati në çdo garë zgjedhore, edhe në atë të fundit të 2007. Këtë vit, Qeveria e Kosovës ka ndarë 305,000 euro për dezinfektim. Me këto mjete janë blerë 330 spërkatës për eliminimin e rriqrave, të cilat pritet të shfrytëzohen në verën e ardhshme. Mirëpo, Komuna nuk shpreson se kjo shumë e mjeteve mjafton që të eliminohet në tërësi ky problem. Me mjetet vetanake që ka komuna nuk mund të eliminohet ky problem, kurse deri më tani mungon një plan i përbashkët i nivelit

qendror dhe atij lokal se si të trajtohet ky problem, që në shumë raste është treguar fatal për jetën e qytetarëve.

Arsimi. Pas luftës së fundit, infrastruktura shkollore ka qenë shumë e dëmtuar dhe shumë shkolla të kësaj komune kanë zhvilluar mësim në kontejnerë. Nxënësit e shkollës së mesme të qytetit nuk kanë hapësirë të mjaftueshme në objektin e shkollës. Dhjetë klasë të kësaj shkolle mbajnë mësim në një objekt privat, dhe komuna detyrohet t'i paguaj qiranë pronarit të këtij objekti. Po në këtë objekt privat ku mbahet mësimi, ndodhen edhe biznese të tjera, si kateteri, floktar, etj. Kjo e pengon mësimin dhe seriozitetin e nxënësve dhe mësimdhënësve. Përveç kësaj, nëpër shkolla nuk është pastërtia në nivel të duhur. Për shkak të reduktimeve të shpeshta të ujit dhe rrymës, tualetet e shkollave mbeten të pa pastruara dhe prindërit frikohen së fëmijët e tyre do të marrin ndonjë sëmundje nga këto ambiente të papastra. Brengosëse për qytetarët është edhe kualiteti i mësimdhënies. Prej 848 mësimdhënësve në vitin shkollor 2008/09, vetëm 168 prej tyre (19.81%) janë me fakultet dhe ligjërojnë në drejtimet përkatëse; 31 mësimdhënës (3.66%) janë me fakultet në drejtime jo përkatëse; 420 mësimdhënës (49.53%) janë me shkollim të lartë profesional (18 prej këtyre në drejtime jo përkatëse); 50 mësimdhënës (5.9%) janë me shkollë normale; dhe 161 (18.99%) janë me shkollim të mesëm (në studime). Kjo statistikë tregon se pjesa më e madhe e mësimdhënësve nuk janë të kualifikuar dhe shumë prej tyre nuk japin mësim në drejtimet përkatëse për të cilat janë të thirrur. Qytetarët nuk kanë vërejtje edhe në sjelljet e profesorëve ndaj nxënësve dhe në përgjithësi në punën e tyre në arsim. Për këtë qëllim ka pasur edhe shkrime në gazeta se profesorët përdorin alkool në orët e punës; pinë qaj në kabinetet e tyre, dhe vonohen për orët mësimore. E tërë kjo ka bërë që edhe rezultatet e maturantëve në testin e maturës të jenë në nivel të dobët. Në maturën e vitit 2008 kalueshmëria e maturantëve ka qenë ndër tri më të dobëtat në Kosovë (kalueshmëria ka qenë 26% shkolla e mesme në Malishevë dhe 24% shkolla e mesme në Kijevë).

Administrata. Gjatë një viti, qytetarëve u duhet që të përballen së paku një herë në me administratën e tyre komunale. Ata që gjatë këtyre viteve janë përballë me shërbimet e administratës, kanë vërejtje të shumta sa i përket rregullit në këtë sektor publik. Vërejtjet jepen më së shumti në funksionimin e ofiqarisë. Në përgjithësi administrata nuk ka një objekt të përshtatshëm për punë. Ofiqaria është e ndarë nga objekti kryesor i komunës. Qytetarët shprehen se për të marrë një certifikatë duhet që të trokitet në katër zyre të ndryshme. Përkundër orarit të shtuar gjatë sezonit së verës, qytetarët e Malishevës dhe mërgimtarët e kësaj komune, janë përballur me radhë të gjata për marrjen e dokumenteve, si në komunë ashtu edhe në zyrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme ku bëhet lëshimi i letërnjoftimeve dhe pasaportave. Për shkak të mosfunksionimit të Zyrave të Vendit nëpër lokalitet tjera të kësaj komune, të gjithë qytetarëve u duhet që të marrin dokumentet në një objekt të vetëm. Orari i punës sipas bashkëbiseduesve nuk respektohet. Qasja në dokumente zyrtare është e vështirë dhe komuna aplikon masa të kundërligjshme. Për qasje në dokumente zyrtare duhet bërë kërkesë në zyrën e arkivit, e që në anën tjetër paraqitja e kërkesës kushton me pagesë prej 1€. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për qasje në dokumente zyrtare.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në zgjedhjet e fundit komunale, ku për herë të parë qytetarët kishin mundësinë që përveç anëtarëve për Kuvend Komunal të zgjidhnin drejtpërdrejt edhe kryetarin e komunës, fitues doli kandidati i PDK-së Isni Kilaj – ish kryeshef ekzekutiv në këtë komunë. Në raundin e parë Isni Kilaj fitoi 7,615 vota apo 45.7%, kurse në zgjedhjet e balotazhit fitoi me 8,309 vota apo 54.9%.

Gjatë debateve para elektorale, tanimë fituesi i zgjedhjeve për kryetar në këtë komunë, kishte premtuar ndërtim të objekteve shkollore, asfaltim të rrugëve, shtrim të rrjetit të kanalizimeve dhe ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës. Sa i përket ndërtimit të objekteve shkollore, ky premtim është përmbushur në masë të madhe. Me mjetet e saj vetanake komune nuk ka mundur të ndërtoj asnjë objekt shkollor, mirëpo ka participuar në projektet e nivelit qendror. Me ndihmën e MASHT është ndërtuar shkolla në Mleqan, kurse me ndihmën e MAPL është ndërtuar shkolla në Tërpezë. Në Gurishtë ende nuk ka filluar ndërtimi i objektit shkollor ashtu siç ishte premtuar. Përkundër premtimeve dhe një investimi të bërë në rrjetin e kanalizimit, problemi më i madh në këtë komunë mbetet kanalizimi i ujërave të zeza. Tabela më poshtë pasqyron disa nga premtimet e dhëna nga kryetari i komunës dhe realizueshmëria e tyre pas dy vite të qeverisjes.

Tab. 1. Premtimet dhe realizimi i tyre

Premtimet	Realizimi
Ndërtimi i shkollave në Gurishtë, Tërpezë, Vërmicë, Mleqan	Ky premtim është realizuar në masë të madhe. Përveç në Gurishtë, objektet shkollore janë ndërtuar në të gjitha lokalitetet e përmendura.
Asfaltimi i rrugëve Banjë-Gajrak, Lagja e Mirditës, etj.	Ky projekt është realizuar.
Investime në përmirësimin dhe ndërtimin e sistemit të kanalizimit	Në listën e investimeve kapitale për vitet 2008 dhe 2009 figurojnë vetëm një projekt i ndërtimit të kanalizimeve. Në vitin 2008 janë dhënë 3,353.50 € për ndërtimin e kanalizimit të fshatit Bajë.
Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës	Gjatë vitit 2008 nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Me projektet kapitale të vitit 2009, komuna ka ndarë një shumë prej 200,000 eurove për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës. Deri në tetor 2009 këto mjete nuk janë shfrytëzuar në këtë drejtim dhe nuk kanë filluar punimet në këtë objekt.

Zgjedhjet lokale në Malishevë

Me mbarimin e luftës në qershor të vitit 1999 e deri në zgjedhjet e para lokale në vjeshtë të vitit 2000, kryetar i komunës së Malishevës ishte emëruar Gani Krasniqi. Gani Krasniqi dhe administratori ndërkombëtar i kësaj komune kishin qeverisur me

komunën deri në zgjedhjet e para lokale në vitin 2000. Në këto zgjedhje, fitues doli LDK e cila fitoi shumicën e ulëseve në Kuvend Komunal (KK). Kryetar i Kuvendit Komunal ishte zgjedhur Jakup Kastrati. Në zgjedhjet e dyta lokale dy vite më vonë, zgjedhjet i fitoi PDK, dhe kryetari i kësaj partie Gani Krasniqi u zgjodh edhe kryetar komune. Gani Krasniqi dhe PDK qeverisën me komunën për pesë vite, deri në zgjedhjet e treta lokale në nëntor 2007. Edhe në nëntor 2007 PDK sërish fitoi zgjedhjet për herë të dytë radhazi, dhe kandidati i kësaj partie Isni Kilaj u zgjodh kryetar komune.

Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme lokale në këtë komunë, kanë konkurruar 19 subjekte të ndryshme politike. Mirëpo në Kuvendin prej 31 anëtarësh, në tri palë zgjedhjet e gjertanishme, kanë arritur që të përfaqësohen 6 subjekte politike dhe një kandidat i pavarur. Vetëm tri parti politike kanë siguruar përfaqësim të vazhdueshëm në tri legjislaturat komunale. AAK në tri mandatet ka pasur vetëm një anëtar në KK të Malishevës dhe ka pasur një rritje të lehtë të votave në çdo zgjedhje. PDK ka pasur një rritje të votave në zgjedhjet e vitit 2002, por në zgjedhjet e vitit 2007 ka pasur një rënie në vota për afro 3,000 votues, numri më i ulët i votuesve për këtë parti në tri palë zgjedhjet lokale. Përkundër numrit më të ulët të votave që ka marrë kjo parti, PDK ka fituar shumicën dërmuese të ulëseve edhe në zgjedhjet e nëntorit 2007. Humbje të votave vazhdimisht ka pësuar LDK. Që nga zgjedhjet e para në 2000 e deri tek ato të fundit në 2007, numri i votuesve të LDK-së është përgjysmuar. Tri parti politike kanë arritur të përfaqësohen për herë të parë në legjislaturën e tretë, dhe të triat përfaqësohen me vetëm nga një anëtarë.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Malishevës.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	8168	13	10559	17	7908	16
LDK	10018	16	8635	13	5225	11
AAK	415	1	565	1	694	1
LDD	-	-	-	-	723	1
AKR	-	-	-	-	737	1
ORA	-	-	-	-	262	1
Gani S. Krasniqi	446	1	-	-	-	-

Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme lokale në Malishevë numri i votuesve ka shkuar duke rënë vazhdimisht. Përderisa numri i qytetarëve me të drejtë vote ka shkuar duke u rritur nga viti në vit, pjesëmarrja në votime ka shkuar duke rënë. Në zgjedhjet e para lokale, kur qytetarët e kësaj komune kishin mundësinë që për herë të parë të votojnë për përfaqësuesit e komunës së tyre, dalja në votime ishte në masën 85.1%. Dy vite më vonë kjo shifër ra në 63.1%. Edhe në zgjedhjet e fundit lokale të nëntorit 2007 ka pasur rënie në pjesëmarrjen në votime. Pasi që numri i qytetarëve me të drejtë vote është rritur dukshëm në zgjedhjet e 2007, dalja në votime ka qenë më e ulët se ajo e 2002. Në zgjedhjet e ardhshme të nëntorit 2009, 42,310 kanë të drejtë vote.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Malishevë në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

Votues	2000	2002	2007 ²
Votues me të drejtë vote	25107	32693	?
Pjesëmarrja në votime	21366	20635	15988
Përqindja e daljes në votime	85.1%	63.12%	?%

Buxheti i Komunës

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Malishevës ka shkuar gjithnjë duke u rritur, përveç në vitin 2005, ku ka shënuar rënie në krahasim me buxhetin e një viti më parë. Në vitin 2005 ka pasur rënie të buxhetit në të gjitha kategoritë tjera përveç në investime kapitale. Nga buxheti i gjithëmbarshtëm i komunës, pjesa më e madhe e mjeteve ndahet për rroga dhe mëditje të punëtorëve në shërbimin publik komunal. Buxheti i komunës ka pasur një rritje të ngadalshme dhe për katër vite radhazi (2004-2007) buxheti i gjithëmbarshtëm i komunës nuk ka arritur të kaloj shifrën prej 4 milion eurosh.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2009	3,861,879	681,537	157,832	60,000	1,756,628	6,517,876
2008	3,215,468	756,104	157,833	55,000	952,386	5,136,791
2007	3,070,398	659,967	151,360	55,000	798,039	4,734,764
2006	3,032,048	599,688	127,828	55,000	651,337	4,465,901
2005	2,912,082	544,769	67,003	15,710	598,721	4,138,285
2004	2,950,029	1,205,208	-	-	433,329	4,588,566
2003	2,217,754	881,474	-	-	463,147	3,577,975

Në vitin 2009, buxheti total i komunës ka shënuar ngritje dhe tani kap shifrën mbi 6.5 milion euro. Nga këto mjete, linja buxhetore që më së shumti është rritur është ajo e investimeve kapitale. Edhe linja buxhetore për paga ka shënuar një rritje prej mbi gjysmë milion eurosh.

Investimet kapitale

Në vitin 2009, Komuna e Malishevës ka një buxhet prej 1,756,628 € për investime kapitale. Kurse që nga viti 2003 e deri në vitin 2008, për gjashtë vite janë shpenzuar rreth 3.8 milion euro. Këto mjete janë mjete nga buxheti i komunës, pa llogaritur investimet kapitale nga niveli qendror. Gjatë këtyre dy viteve të fundit është investuar mjaft në infrastrukturën shkollore dhe rrugore. Tabela më poshtë paraqet disa nga projektet më me rëndësi të cilat janë realizuar me mjete vetanake të komunës:

² Numri i votuesve me të drejtë vote nuk ka mundur që të sigurohet përkundër kërkesës drejtuar KQZ-së.

Tab.5. Investimet më të rëndësishme kapitale

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës Drenoc-Vërmicë-Llozicë	€130,484
2008	Asfaltimi i rrugës Bellenicë-Ngucat-Bardh	€163,553
2008	Asfaltimi i rrugës në qytet	€66,577
2008	Asfaltimi i rrugës Carrallukë-Shkarashnik	€62,402
2009	Ndërtimi i rrugës në Golesh	€100,000
2009	Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Trepëzë	€179,859
2009	Asfaltimi i rrugës Limaj-Surdhaj-Bajë	€91,325

Kuvendi Komunal i Malishevës ka miratuar edhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2010-2012. Sipas këtij dokumenti, janë paraparë të hyrat vetanake, investimet kapitale dhe buxheti i përgjithshëm për tri vitet në vazhdim.

Tab.6. Korniza Afatmesme Buxhetore 2010-2012 e Komunës së Malishevës

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	7,479,219	7,626,393	7,885,734
Të hyrat vetanake në €	808,673	834,345	858,413
Investimet kapitale në €	2,458,135	2,340,932	2,409,712

Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, Komuna e Malishevës do të ketë në dispozicion **7,208,779 milion €** për investime kapitale. Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Malishevës për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se **9.7 milion €** për investime kapitale.

Administrata komunale

Në shërbimin publik komunal janë të punësuar 1,283 punonjës. Ky numër llogaritet për punonjësit në arsim, shëndetësi dhe administratë lokale. Në vitin 2009, numri i punëtorëve në këta tre sektorë ka rënë ndjeshëm në krahasim me vitin 2008. Por kjo rënie është në nivel pothuajse të njëjtë me numrin e punonjësve në vitin 2007. Përqindjen më të madhe të të punësuarve në shërbimin publik komunal e përbëjnë të punësuarit në arsim (1,001 punonjës deri në mars të vitit 2009).

Në administratën komunale janë të punësuar 125 punonjës. Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 10/46 të 3 dhjetorit 2008 komunat të cilat kanë më pak se 100,000 banorë, në administratat e tyre lokale duhet të kenë një të punësuar për çdo 620 banorë. Sipas kësaj formule, del se Komuna e Malishevës duhet të punësoj ende staf deri sa të arrij kuotën prej 139 punonjësish.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Malishevës sipas viteve

Viti	Nr. total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	1283

2008	1537 ▲
2007	1234
2006	1261 ▲
2005	1255 ▲
2004	1247 ▲
2003	1082 ■

Komuna e Malishevës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Komuna e Malishevës gjatë vitit 2008 ka respektuar në masë të madhe Ligjin për vetëqeverisje lokale. Kuvendi Komunal i Malishevës gjatë vitit 2008 ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta. Në këto mbledhje, KK ka miratuar dy rregullore komunale. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) ka mbajtur 10 takime të rregullta. Përveç KPF-së, KK i Malishevës ka të formuara edhe pesë komitete tjera, të cilat kanë qenë më pak aktive. Kryetari i Komunës së Malishevës ka mbajtur tri tubime publike me qytetarë. Në Kuvendin Komunal të Malishevës gjatë vitit 2008 nuk është paraqitur asnjë peticion nga ana e qytetarëve.

Transparenca në komunën e Malishevës nuk është në nivel. Qasja në dokumente zyrtare është e vështirë. Çdo qytetar që dëshiron të ketë qasje në dokumente zyrtare duhet të bëjë pagesën prej 1€. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për qasje në dokumente zyrtare. Komuna e Malishevës ka edhe ueb faqen e saj zyrtare. Ueb faja është e mirëmbajtur në baza të rregullta kohore. Është e pajisur me informacione të konsiderueshme aq sa një qytetari të Malishevës do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të komunës. Mirëpo, gjatë hulumtimit në ueb faqe vërehen zbrazëti të konsiderueshme në lidhje me informacione rreth qytezës, tejet informacione të pakta lidhur me shërbimet komunale, etj.

Tab.8. Niveli i përbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Malishevës (www.malisheva-komuna.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ³
Ballina	4
Organizimi komunal	4
Shërbimet komunale	1.8
Info rreth qytetit	2.63
Projektet komunale	3
Lajme & lajmërim	3
Harta e faqes	3
Kontakt	5
Gjuhët	3
Fusha për kërkim	5
Tjera informacione shtesë	3
Baza Ligjore	3
Mesatarja totale	3.37

³ (radhitja nga 1 deri 5) 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Gjendja në arsim

Arsimi mbetet një nga fushat më problematike në jetën publike komunale në Malishevë. Përkundër investimeve të mëdha që janë bërë në infrastrukturën shkollore, problem edhe më tutje mbetet kualiteti i mësimdhënies. Viteve të fundit, Qeveria e Kosovës ka ndërtuar disa objekte shkollore të cilat e kanë zgjidhur një pjesë të problemit për hapësirë shkollore. Gjatë mandatit të kaluar qeverisë, në Llapçevë është ndërtuar një shkollë e re me ndihmën financiare të MASHT. Në vitin 2008, MASHT ka filluar me ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Stapanicë. Po në vitin 2008, dhe po ashtu me mjete të MASHT, është filluar ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Mleqan, por i cili ende nuk ka përfunduar deri më tani dhe nxënësit e këtij fshati edhe më tutje zhvillojnë mësimin në kontejnerë. MAPL dhe komuna kanë financuar ndërtimin e një tjetër objekti të shkollës fillore në fshatin Tërpezë. Në tetor të këtij viti, është vënë gur-themeli për ndërtimin e shkollës së mesme profesionale, investim i Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë Norvegjeze.

Në Malishevë nuk funksionon asnjë çerdhe. Në këtë komunë funksionojnë dy shkolla të mesme dhe 42 shkolla fillore. Të gjitha shkollat janë në gjuhën shqipe. Në shkollat e arsimit fillor, raporti nxënës/mësimdhënës është 18.27 (një mësimdhënës për 18.27 nxënës); kurse në shkollat e arsimit të mesëm ky raport është 24.0. Prej 848 mësimdhënësve në vitin shkollor 2008/09, 168 prej tyre (19.8%) janë me fakultet dhe ligjërojnë në drejtimet përkatëse; 31 mësimdhënës (3.7%) janë me fakultet në drejtime jo përkatëse; 420 mësimdhënës (49.5%) janë me shkollim të lartë profesional (18 prej këtyre në drejtime jo përkatëse); 50 mësimdhënës (5.9%) janë me shkollë normale; dhe 161 (19.0%) janë me shkollim të mesëm (në studime). Sigurimi i kuadrove për mësimdhënie në lëndët e anglishtes, informatikës, muzikës dhe artit është shumë i vështirë dhe zakonisht këto lëndë i ligjërojnë mësimdhënësit e profileve tjera arsimore, ose këto lëndë përdoren për të mbushur kuotën e urëve të mësimdhënësve tjerë.

Gjendja në shëndetësi

Edhe në fushën e shëndetësisë gjendja nuk paraqitet më e mirë. Shërbimi shëndetësor në komunën e Malishevës është i organizuar në kuadër të Qendrës Komunale për Mjekësi Familjare (QKMF) "Shpëtim Robaj", në Malishevë. Kjo qendër ka gjashtë njësi organizative në terren, të cilat funksionojnë si Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe atë në fshatrat: Kijevë, Bellanicë, Tërpezë, Pagarushë, Panorc dhe Drenovc. Si ambulanca shëndetësore/punkte, funksionojnë dhjetë njësi, dhe atë në fshatrat: Carrallukë, Dragobil, Astrazubë, Llapqevë, Shkozë, Kravasari, Fshati i Ri, Llagicë, Lumishtë dhe Lladrovç. Në këto punkte shëndetësore nuk punohet me orare të rregullta kohore. Në sektorin e shëndetësisë në përgjithësi janë të angazhuar 126 punëtorë, prej të cilëve 20 mjekë (ose 16.0%), 75 teknikë mjekësorë (ose 60.0%), 31 punëtorë ndihmës (ose 24.0%). Në strukturën gjinore të të punësuarve në këtë sektor marrin pjesë gjinia mashkullore me 56.3% dhe gjinia femërore me 43.7%. Krahas sektorit publik të shëndetësisë, në komunë veprojnë edhe 7 ordianca mjekësore private dhe atë: 2 stomatologjike, 2 gjinekologjike, 2 internistike, 1 pediatrike dhe 1

ortopedike. QKMF përballet me probleme të shumta. Ka mungesë të mjekëve specializant. Që nga fillim viti 2008 është angazhuar një pulmolog i cili punon me orar të kufizuar ngase nuk është nga Malisheva. Ka mungesë të barnave nga lista esenciale. Ka mungesë të autoambulancave. Gjatë këtyre dy viteve të fundit, komuna ka blerë një autoambulancë në vlerë prej 40,000 eurove; është bërë renovimi i tërësishëm i QMF në Bajë (25,000 euro), etj. Edhe më tutje problemi më i madh në shëndetësi mbetet trajtimi i rasteve nga ethet hemorragjike. Për rastet më të rënda, siç janë ethet hemorragjike, qytetarët i drejtohen spitaleve regjionale në Gjakovë, Prishtinë dhe Prizren.

Shoqëria civile

Në Komunën e Malishevës nuk ka shoqëri civile aq aktive, e cila avokon për problemet e ndryshme me të cilat përballet kjo komunë. Edhe përkundër një numri të madh të organizatave jo qeveritare që janë të regjistruara, më aktivet në një farë forme janë vetëm OJQ "Vizioni i Ardhmërisë" dhe Qendra Rinore. Fokusi i këtyre dy organizatave janë aktivitetet rinore. Nuk ka organizatë të shoqërisë civile e cila monitoron punën e trupave komunale, siç është puna e Kuvendit Komunal, transparenca, aktivitetet e ndryshme të komunës. Nuk ka organizim të shoqërisë civile që mundohet të shtyjë projekte, të ndikoj në përmirësimin e projekteve komunale, të organizoj debate, etj. Gjatë vitit 2008 dhe pjesës së parë të vitit 2009, nuk është dorëzuar asnjë peticion në Komunën e Malishevës.

Mediat lokale

Në Komunën e Malishevës funksionon vetëm një radio lokale - Radio "Malisheva". Kjo radio bën transmetimin e mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe ka program të rregullt informativ në të cilat pasqyrohen edhe ngjarjet brenda komunës dhe aktivitetet e qeverisë komunale. Radio "Malisheva" është aktive me debate, sidomos në kohën e fushatës zgjedhore. Ky medium nuk është i qëndrueshëm financiarisht, dhe varet shumë nga reklamat dhe publikimet e tjera. Sipas bashkëbiseduesve politika në nivel lokal nuk sheh ndonjë interes që të ndikoj në këtë medium, por as mediumi nuk i trazon në punën e tyre të përditshme partitë politike. Përveç kësaj radioje, edhe gazetat ditore kanë korrespondentët e tyre në këtë komunë. Korrespondent kanë "Koha Ditore", "Zëri" dhe "Bota Sot". Korrespondentët e këtyre gazetave zakonisht shkruajnë për aktivitetet komunale, siç janë mbledhjet e Kuvendit Komunal apo edhe përrurimi i projekteve komunale. Kritika ndaj pushtetit komunal zakonisht pasqyrohet përmes prononcimeve të partive opozitare. Lajmet kryesore për keqpërdorime zakonisht raportohen nga gazetarët e nivelit qendror. Sipas vetë gazetarëve, politika mundohet që të ndikoj tek ta në shumë mënyra dhe presioni ndaj gazetarëve rritet sa herë që këta të fundit shkruajnë për gjërat që nuk i shkojnë për shtati pushtetit komunal apo partive politike në përgjithësi.

Rendi dhe ligji në Komunën e Malishevës

Nga 1 janari 2008 deri më 31 dhjetor 2008, në Komunën e Malishevës kanë ndodhur 770 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 43 shkelje të natyrave të ndryshme. Numri prej 770 rasteve e rendit këtë komunë në vendin e 21-të në

krahasim me komunat e tjera për numrin e përgjithshëm të rasteve të shkeljes së rendit dhe ligjit. Në të gjitha fushat e shkeljes së rendit dhe ligjit, kjo komunë gjendet në mes të tabelës në krahasim me komunat tjera. Vetëm në kategorinë e “pengimit të personave zyrtar” në këtë komunë janë shënuar 21 raste, e që në krahasim me komunat tjera në këtë kategori Komuna e Malishevës radhitet e 12-ta.

Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Malishevë (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	240
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	58
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	21
Vjedhje e pyjeve	8
Incidente lidhur me pronën	33
Vjedhje	123
Abuzime seksuale	4
Shkaktim të dëmtimeve trupore	58
Kërcënime	46
Mashtrime	23
Vrasje	3
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	-

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifatatimore të lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj rregulloreje të UNMIK-ut, Kuvendi Komunal i Malishevës ka miratuar Rregulloren komunale për tatim në pronë për vitin 2009. Sipas kësaj rregulloreje, Komuna e Malishevës ndahet në katër zona dhe norma tatimore, varësisht nga zona në zonë, sillet prej 0.07-0.13%.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Malishevës

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.09%	0.09%	0.13%	0.10%	0.07%
I	350 €	340 €	630 €	300 €	200 €
II	-	300 €	400 €	270 €	200 €
III	-	250 €	300 €	250 €	200 €
IV	-	200 €	240 €	240 €	200 €

Kostoja për biznese

Deri në prill të vitit 2008, në Komunën e Malishevës kanë qenë të regjistruara 4,317 biznese private. Leja për hapjen e biznesit në këtë komunë ndryshon në bazë të llojit të bizneseve. Tabela më poshtë pasqyron disa nga bizneset më të mëdha dhe më të shpeshta që mund të gjinden në këtë komunë, dhe taksa për leje që ato duhet të paguajnë në Komunën e Malishevës.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	600 €
Kontrolli dhe analiza teknike	400 €
Auto-shkollat	200 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	600 €
Hortikultura	200 €
Tregtia me shumicë e automjeteve (bujqësore, Motorike, etj)	600 €
Hotelet	400 €
Motelet	400 €
Supermarketet-Hipermarketet	120 - 200 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	80 - 120 €
Kafeteritë	300 €
Restorant	180 - 250 €
Telekomunikimit	100 - 250 €
Gurëthyesit	450 €
Përpunimi i mishit	250 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	60 - 250 €
Pompat e benzinës	350 - 450 €
Barnatoret	300 €
Ndërmarrjet ndërtimore	500 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	150 - 300 €